

AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

**Lënda:** LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR KËRKESAT PËR PROJEKT KËRKIMOR-SHKENCOR TË RI

*Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti në varësi të projektit që do të zhvillohet dhe zonën përkatëse, dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.*

- 1. Kërkesë për miratim projekti kërkimor-shkencor** e firmosur nga përfaqësuesi i institucionit të specializuar IA/QSA, shoqëruar me dokumentacionin për çdo projekt të ri.
- 2. Pagesa e tarifës së aplikimit** miratuar me. Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015.
- 3. Kopje të vendimit** për miratimin e projektit nga **Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë**.
- 4. Marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e huaja**, ku pjesë e aneksit të saj të jetë akti me të cilin është përcaktuar përfaqësuesi i institucionit të huaj dhe atë shqiptar, firmosur dhe vulosur nga organi që ka nxjerrë aktin (origjinale ose fotokopje e njëzuar me origjinalin).
  - Plani i përgjithshëm me koordinatat në një nga sistemet e më poshtme koordinatave:
    - Albanian 1987, EPSG:4191
    - Albanian 1987 / Gauss-Kruger zone 4, EPSG: 2462
    - WGS 84, EPSG: 4326
    - WGS 84 / UTM zone 34N, EPSG: 32634
    - KRRGJSH 2010 (ETRS89 / Albania TM 2010), EPSG: 6870ku të jetë evidentuar me koordinata zona ku do të kryhet ndërhyrja/procesi arkeologjik. Plani duhet të dorëzohet në një nga formatet vektoriale në të cilin është përpunuar, si **DWG, DXF, SHP**, etj. Në rastin kur projekti është hartuar në programe **GIS**, bashkë me **SHP** duhen dorëzuar dhe skedarët e projekteve (**MXD për ArcGIS apo QGS për Quantum GIS**).
  - Emërtimi i projektit, shkaku, lloji i ndërhyrjes dhe qëllimi i tij (Emërtimi i projektit duhet të jetë i pandryshueshëm gjatë gjithë vazhdimësisë së tij).
  - Përshkrimi me të dhënat teknike të vendit ku do të kryhet operacioni, të sipërfaqes dhe thellësisë.
  - Renditja e të dhënave arkivore, vlerësimi i hartave të vjetra dhe i atyre të reja, foto ajrore, të dhëna mbi ndërhyrjet e mëparshme në sipërfaqen e gërmimit, informacione mbi ndryshimet natyrore të shekujve të kaluar mbi historinë e saj, botimet e ndryshme, etj.
  - Përcaktimi i pritshmërisë shkencore (çfarë pritet të zgjidhë projekti në fjalë).

- Drejtuesi ose bashkëdrejtuesit shkencorë të projektit, si dhe lista e ekipit të angazhuar në projekt. Drejtuesi/Bashkëdrejtuesit shkencorë të projektit, nuk mund të ndryshojnë, përveçse në raste madhore. Për çdo ndryshim njoftohet menjëherë KKA.
- Informacion mbi institucionin/institucionet financuese të projektit.
- Periudha kohore (muaji) kur do të realizohet projekti shkencor, për vitin kur aplikohet.
- Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
- Përcaktimi i venddepozitimit të gjetjeve arkeologjike shoqëruar nga lista e gjetjeve. Një kopje e listës së gjetjeve dorëzohet pranë ASHA.
- Në zbatim të VKM Nr.725, Datë 21.05.2008, Pika 13, çdo projekt dhe dokumentacioni që e shoqëron, duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinale ose të noterizuara.
- **Prezantimi në Power-Point** i projektit, ku do të jenë të specifikuara qartë: gjurma në plan, foto të zonës, ndërhyrjet e mëparshme në këtë zonë (nëse ka pasur), gjendja aktuale dhe objektivat që synon projekti ose foto të objekteve që do të studiohen.